

KRONIKË E ZEZË

Një vajzë është arrestuar dhe është dërguar në mbajtje për 48 orë për vrasje në tentativë. Mësohet se i plagosuri është Princ Valentino Corleone, i njohur shkurt me emrin Vali Corleone.

Policia e rajonit të Gjilanit njoftoi përmes një komunikate se në orët e hershme të së enjtes nga Qendra Emergjente Rajonale është informuar se ishte sjellë një person i lënduar nga arma e zjarrit.

“Në vendin e ngjarjes kanë dalë njësitet relevante. Sipas raportit të mjekut viktima P.C. (1983) shqiptar, shtetas i Kosovës është jashtë rrezikut për jetë”, thuhet në njoftim.

Nga hetimet e para në vendin e ngjarjes mësohet se e dyshuara në lidhje me rastin është një vajzë 22-vjeçare e cila sipas policisë dyshohet se e ka shkreput armën.

Për momentin nuk dihen motivet e incidentit.

“Një armë Pistoletë dhe 40 copë fishekë të të njëjtës armë janë konfiskuar në vendin e ngjarjes si prova materiale për Gjykatë”, tha policia.

Prokurori i Shtetit ka urdhëruar që të ngrihet kallëzim penal për "Vrasje në tentativë".

© KOHA. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Komento

#GJILAN

#VRASJE NE TENTATIVE

11 gusht 2022, 09:46

Shpërndaje në



Zhduket Ervis Martinaj,
familjarët thonë se kanë
humbur kontaktet me të

Vazhdon aksioni "Brezovica"

Arrestohen dy persona, u
gjetën me kokainë në një lokal
në Gjiilan

Vdiq një foshnjë 4-muajshe në Istog

Dy shqiptarë kapen me 11 kg heroinë në Zvicër

Në autobusin Tiranë - Prishtinë
tentohet të kontrabandohen
medikamente, ndalohet nga
Dogana

Arrestohen dy burra dhe një grua për prostitucion



TË TJERA

